

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7953  
E shtunë, 14 dhjetor 2024  
Çmimi 0.50

## Tre armiqtë e Albin Kurtit

FAQE 6



Shkruan: Hajdin ABAZI

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# KUSH JANË AKTORËT E HUAJ QË DUAN TA MINOJNË DEMOKRACINË E KOSOVËS?

FAQE 4-5



Aktorë të huaj keqdashës synojnë ta minojnë demokracinë e Kosovës duke shfrytëzuar ndasitë etnike,

deklaroj më 10 dhjetor ambasadori në largim i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, dhe

dha porositë që diçka e tillë nuk duhet të lejohet. Çfarë dihet për këto tentime, dhe si mund të luftohen ato?

## OPINION

### LISTAT E DUBRAVËS, DYZIT E SMREKONICËS!

F. 5

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



## AKTUALE



### MACRONI EMËRON FRANÇOIS BAYROUN KRYEMINISTËR TË RI TË FRANCËS

F. 2

### NGA 1 JANARI 2025 QYTETARËT E BOSNJË-HERCEGOVINËS MUND TË UDHËTOJNË ME LETËRNJOFTIM NË KOSOVË

F. 7

## EKONOMI



### TRANZICIONI ENERJETIK PËR ARRITJEN E EMETIMEVE NETO ZERO DERI NË VITIN 2050 ËSHTË I REALIZUESHËM

F. 8

### DHTIK I SHKRUAN KRYEMINISTRIT KURTI RRETH BLOKADËS SË SHKAKTUAR NGA LIGJI PËR PRONËN PUBLIKE

F. 8

## SPORT

### KOSOVA DHE SHOIPËRIA MËSOJNË KUNDËRSHTARET PËR KUALIFIKIMET E KUPËS SË BOTËS 2026

F. 11

### PDK-ja DËRGON NË KUSHTETUESE 16 LIGJE, TAHIRI: SEANCAT E 5 DHJETORIT SHËNUAN NJË REKORD TË ZI PARLAMENTAR

F. 3



### KOSOVA DHE KROACIA NËNSHKRUAJNË PESË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

F. 5



**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Macroni emëron François Bayroun kryeministër të ri të Francës

PARIS, 13 DHJETOR - Presidenti francez Emmanuel Macron e ka emëruar të premtën politikanin e qendrës, François Bayroun, kryeministër të ri, ka thënë Pallati Elysee, vetëm një javë pas rënies së qeverisë paraprake.

Të mërkurën e kaluar opozita e ka rrëzuar qeverinë e ish-kryeministrit konservator

Michel Barnier për shkak të mospajtimeve për buxhetin, ndonëse ka qenë vetëm tre muaj në zyrë.

Franca është në ngërç politik pasi zgjedhjet e mbajtura në qershor dhe korrik nuk kanë prodhuar ndonjë rezultat të qartë. Ndërkohë, shteti është duke u përballur me situatë kritike në ekonomi, sidomos

për shkak të rritjes së borxhit publik dhe deficitit të madh buxhetor.

Partitë opozitare kanë kërkuar edhe dorëheqjen e Macronit në gjithë këtë krizë ekonomike dhe politike, pasi buxheti për vitin 2025 ende nuk është miratuar.

Por, Macroni ka refuzuar të japë dorëheqje.



## ShBA-ja vendos kufizime të reja për viza ndaj zyrtarëve gjeorgjianë

UASHINGTON, 13 DHJETOR - Shtetet e Bashkuara kanë vendosur kufizime të reja në viza për zyrtarët gjeorgjianë për shkak të "minimit të demokracisë" teksa vazhdojnë të mbahen protesta kundër vendimit të partisë në pushtet, Ëndrra Gjeorgjiane, që t'i pezullojë negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Protestuesit kanë bërë thirrje për zgjedhje të reja pas supozimeve për mashtrime zgjedhore në zgjedhjet parlamentare të tetorit. Opozita nuk e ka njohur këtë rezultat zgjedhor, duke pretenduar se Ëndrra Gjeorgjiane ka kryer mashtrime me vota për të mbetur në pushtet.

Presidentja pro-evropiane, Salome Zurbashvili, e cila



është në anën e protestuesve, ka thënë se zgjedhjet janë manipuluar me ndihmën e Rusisë.

Autoritetet janë përgjigjur dhunshëm ndaj valës së protestave, duke arrestuar qindra njerëz në dy javët e

fundit. Si përgjigje, Departamenti Amerikan i Shtetit ka thënë më 12 dhjetor se do ta ndalojë

lëshimin e vizave për ata që janë përgjegjës ose bashkëpunëtorë në minimin e demokracisë në Gjeorgji.

Nga ky vendim do të preken 20 individë, "përfshirë individë që shërbejnë si ministra apo në parlament, zyrtarë për zbatim të ligjit dhe individë të tjerë".

Prej nisjes së protestave në fund të nëntorit, dhuna kundër opozitës dhe gazetarëve është përshkallëzuar, dhe është dënua ashpër nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Ëndrra Gjeorgjiane, parti në pushtet prej vitit 2012 - e themeluar nga miliardi i afërt me Moskën, Bidzina Ivanishvili - është akuzuar nga kritikët se është bërë secilën herë e më autoritare.

## Shtëpia e Bardhë publikon strategjinë për luftim të urrejtjes kundër myslimanëve dhe arabëve

UASHINGTON, 13 DHJETOR - Presidenti amerikan Joe Biden e ka publikuar një strategji të shumëpritur për ta luftuar urrejtjen kundër myslimanëve dhe kundër arabëve, pas një rritjeje të madhe, qysh prej nisjes së luftës në mes të Izraelit dhe Hamasit.

Hamas është grup palestinez që udhëheq Gazën, i shpallur terrorist prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian.

Dokumenti prej 64-faqesh është publikuar vetëm disa javë para inaugurimit të presidentit të zgjedhur Donald Trump, i cili pati vendosur ndalesë në udhëtim për banorët e disa shteteve me myslimanë myslimane, përgjatë mandatit të tij të parë në Shtëpinë e Bardhë.

Në dokumentin e paraqitur janë vërejtur ngjashmëri me strategjinë për ta luftuar antisemitizmin, të përpiluar nga Shtëpia e Bardhë në shtator të vitit 2023.

Strategjia është publikuar më shumë se një vit pas vrasjes së djaloshtit gjashtëvjeçar Wadea Al-Fayoume, i cili është therur me thikë vetëm pse ka qenë palestinez-amerikan.

Bideni e ka quajtur këtë sulm të "neveritshëm", ka folur për rritjen e krimeve që kanë bazë në urrejtjen kundër myslimanëve dhe arabëve, të cilat i ka quajtur të papranueshme. "Myslmanët dhe arabët meritojnë të jetojnë me dinjitet dhe të shijojnë secilën të drejtë, ashtu sikurse të gjithë amerikanët e tjerë", ka

deklaruar Bideni. "Politikat që rezultojnë me diskriminim kundër disa komuniteteve janë të gabueshme dhe nuk na garantojnë sigurinë".

Këshilli për Marrëdhënie Amerikano-Islamike, organizatë civile për të drejta të njeriut, ka thënë se strategjia është publikuar "vonë", dhe e ka fajësuar Shtëpinë e Bardhë që nuk i ka mbajtur premtimet, përfshirë dhënien fund të luftës në Gazë, që ka rritur islamofobinë.

Trumpi, i cili e ka fituar mbështetjen e një pjese të myslimanëve të zemëruar me mbështetjen e Bidenit për Izraelin në luftën në Gazë, ka thënë se do të vendosë ndalesë për hyrje në ShBA, për secilin që ka pikëpyetje për të drejtën e



Izraelit për të ekzistuar, dhe do t'ua pamundësojë studimet studentëve të huaj që kanë qasje "antisemitike".

Tensionet në mes të grupeve pro-izraelite dhe pro-palenezite në disa kompleks amerikane janë rritur dukshëm, pas sulmeve të Hamasit në jug të Izraelit, më 7 tetor të vitit 2023.

Si pasojë e sulmeve janë vrarë mbi 1 200 njerëz dhe janë marrë peng mbi 240 të tjerë. Izraeli ka nisur më pas fushatë ushtarake në Gazë, me qëllim të shkatërrimit të grupit Hamas. Si pasojë e ofensivës janë vrarë më shumë se 45 000 palestinezë, kryesisht gra dhe fëmijë, sipas autoriteteve shëndetësore palestineze.



## Pranohen me shkrim dëshmitë e nëntë dëshmitarëve në rastin e liderëve të UÇK-së

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Në çështjen gjyqësore kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 11 dhjetor trupi gjyqësor ka miratuar pjesërisht kërkesën e Prokurorisë për t'i pranuar dëshmitë e nëntë dëshmitarëve me shkrim. Kjo është bërë me dije përmes konferencës javore të DhSK-së nga zëdhënësi Michael Doyle. Po gjatë kësaj konferencë është thënë se më 9 dhjetor trupi gjyqësor ka miratuar kërkesën e një dëshmitari për të dhënë dëshmi me masa mbrojtëse

përmes videolidhjes, raporton "Betimi për Drejtësi". Ndërsa në çështjen Salih Mustafa, sipas zëdhënësit Doyle, kryetarja e DhSK-së ka caktuar një panel të Gjykatës Supreme, më 10 dhe 11 dhjetor, për të vendosur lidhur me dy kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë: përkatësisht një nga Mustafa dhe një nga prokuroria. "Të dyja kërkesat lidhen me vendimin e Gjykatës së Apelit me titull Vendim për Lëshimin e një Vendimi të Ri Dënimi për Salih Mustafën. Z. Mustafa pretendon se paneli i Gjykatës së Apelit ka

shkelur ligjin në përcaktimin e dënimit për akuzën e vrasjes së paligjshme dhe i kërkon Panelit të Gjykatës Supreme të caktojë dënim më të ulët për këtë akuzë, ose t'ia kthejë panelit kompetent për vendim të ri. Prokuroria kundërshton ligjshmërinë e dënimit me 15 vjet të dhënë nga Dhoma e Apelit si tepër të ulët dhe i kërkon Panelit të Gjykatës Supreme t'ia kthejë çështjen Panelit të Apelit për të caktuar një dënim të ri", ka thënë Doyle. Gjatë kësaj konference është folur edhe për aktakuzat kundër Hashim Thaçit, Bashkim



Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit, akuzat që lidhen me pretendime për përpjekje të paligjshme për të ndikuar ndaj dëshmitarëve.

## PDK-ja dërgon në Kushtetuese 16 ligje, Tahiri: Seancat e 5 dhjetorit shënuan një rekord të zi parlamentar

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Kryetari i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka dërguar sot në Gjykatën Kushtetuese 16 ligje të miratuara në seancat e mbajtura më 5 dhjetor 2024, duke i kontestuar ato për shkelje procedurale dhe njërin prej tyre edhe për shkelje të përmbajtjes. Tahiri tha se këto seanca, që shënuan një rekord të zi parlamentar, kanë dhunuar rendin tonë kushtetues, duke cenuar rolin, funksionin dhe mandatin e deputetëve, komisioneve parlamentare dhe vetë Kuvendit. "Çfarë ndodhi më 5 dhjetor ishte një shembull flagrant i shkeljes së Rregullores së Kuvendit dhe praktikave demokratike të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe atyre evropiane. Gjithë këto ligje, shumica e të cilëve u miratuan brenda së njëjtës ditë, janë rezultat i një procesi të papranueshëm që dëmton



integritetin parlamentar", theksoi ai. Nga 16 ligjet e kontestuara, 15 ligje janë kontestuar për shkelje procedurale, ndërsa Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme është kontestuar si në procedurë ashtu edhe në përmbajtje. Tahiri theksoi disa nga shkeljet kryesore dhe flagrante të Procedurave Parlamentare si miratimi i këtyre ligjeve pa miratim paraprak të rendit të ditës nga Kryesia e Kuvendit,

thirrja e seancave me njoftime të vonuara e të papërshtatshme për deputetët, duke pamundësuar shqyrtimin dhe amendamentimin e materialeve ligjore, si dhe procesi i miratimit të ligjeve, nga shqyrtimi në lexim të parë deri në miratim përfundimtar, është zhvilluar brenda një dite të vetme, duke shkelur Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit. "Edhe thirrja e këtyre seancave dhe njoftimi i deputetëve për mbajtjen e tyre është bërë në mënyrë kundërkushtetuese dhe

të kundërligjshme, vërtetohet edhe me njoftimet dhe ftesat zyrtare që ne i kemi pranuar si deputetë, e të cilat simbolikisht i demonstroj dhe prezantoj para juve", shtoi ai.

Tahiri tha se deputetët kanë të drejtë elementare kushtetuese dhe ligjore që të njoftohen së paku 48 orë më herët për mbajtjen e seancave, që t'i shqyrtojnë materialet e tyre, të përgatiten lidhur me to. "Për shembull, për seancën e caktuar të mbahet për në orën 14:40, deputetët e Kuvendit janë njoftuar me 21 minuta vonë, pra në orën 15:01. Për seancën e caktuar për orën 19:30, deputetët janë ftuar po ashtu me vonë në orën 19:31. Për seancën e caktuar për orën 20:10, deputetët janë njoftuar vetëm 2 minuta më herët, pra në orën 20:08. Për seancën e caktuar për orën 22:30, deputetët janë njoftuar në orën 22:42", tha ai.

Sipas Tahirit, PDK-ja mbetet e përkushtuar për mbrojtjen e Kushtetutës, rendit kushtetues

dhe institucioneve demokratike, si dhe duke adresuar këto raste në Gjykatën Kushtetuese, synohet të parandalohet krijimi i precedentëve që cenojnë të drejtat e qytetarëve dhe shkelin parimet e shtetit të së drejtës. "Kontestimi i këtyre ligjeve nuk është vetëm një domosdoshmëri për mbrojtjen e parimeve kushtetuese, por edhe një detyrë për t'i parandaluar dëmet që këto ligje mund të shkaktojnë ndaj interesit publik dhe demokratik. Si deputetë të PDK-së ne do të vazhdojmë ta mbrojmë Kushtetutën dhe të sigurojmë që Kuvendi të funksionojë siç e parasheh ligji", tha Tahiri.

Partia Demokratike e Kosovës fton Gjykatën Kushtetuese të vlerësojë me kujdes shkeljet e evidentuara dhe të sigurojë që proceset ligjore t'i respektojnë parimet kushtetuese të Republikës së Kosovës. "Miratimi i ligjeve duhet të bazohet në transparencë dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve", përfundoi Tahiri.

## Normalizimi me Kosovën, ndër kushtet e BE-së për avancimin e Serbisë

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Hapja e grupit të tretë të kapitujve për anëtarësimin e Serbisë në Bashkimin Evropian do të merrret në konsideratë pasi ky vend të bëjë përparim të rëndësishëm në fushën e sundimit të ligjit - kapitujt 23 dhe 24 - si dhe në procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën. Kështu është thënë në versionin e përditësuar të draft-konkluzioneve për Serbinë, të cilat do të diskutohen të premten nga ambasadorët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Në këtë dokument përsëritet se përparimi i Serbisë në fushën e sundimit të ligjit dhe në normalizimin e marrëdhënieve

me Kosovën "do të vazhdojë ta përcaktojë ritmin e përgjithshëm të negociatave të anëtarësimit". Konkluzionet për zgjerimin duhet të miratohen në nivel ambasadorësh dhe më pas të miratohen formalisht në takimin e ministrave për Çështje Evropiane që do të mbahet më 17 dhjetor në Bruksel. Negociatat në mes të Brukselit dhe Beogradit për anëtarësim të Serbisë në bllok janë të ngrira kryesisht për shkak të mosvendosjes së sanksioneve ndaj Rusisë nga ana e palës serbe. Serbia nuk ka hapur asnjë kapitull që nga dhjetori i vitit 2021. Hungaria, e cila kryeson



Bashkimin Evropian deri më 31 dhjetor, e ka lënë të hapur mundësinë për hapjen e grupit të tretë të kapitujve për Serbinë,

për të cilin Komisioni Evropian konsideron se vendi është teknikisht i gatshëm. Megjithatë, Hungaria është përballur me

rezistencë nga një numër i caktuar shtetesh anëtare që, përveç problemit të harmonizimit me politikën e jashtme të BE-së, këmbëngulin për përparim në sundimin e ligjit dhe zbatimin e marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën.

Për çdo vendim mbi mundësinë e hapjes ose mbylljes së kapitujve apo grupit të kapitujve në procesin e anëtarësimit është i nevojshëm pëlqimi i të gjitha shteteve anëtare të BE-së. Prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, vetëm Kosova nuk e ka statusin e vendit kandidat për anëtarësim në bllokun evropian, ndonëse ka aplikuar.



# Kush janë aktorët e huaj që duan ta minojnë demokracinë e Kosovës?

Aktorë të huaj keqdashës synojnë ta minojnë demokracinë e Kosovës duke shfrytëzuar ndasitë etnike, deklaroi më 10 dhjetor ambasadori në largim i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, dhe dha porosinë që diçka e tillë nuk duhet të lejohet. Çfarë dihet për këto tentime, dhe si mund të luftohen ato?

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Avancimin e shpejtë të teknologjisë, krahas të mirave të saj, njerëzimi e ka paguar shtrenjtë. Dezinformimi është një prej pasojave më të mëdha anësore. Kosova nuk është aspak immune nga ky trend që ka prekur gjithë botën. Teksa informacionet e rreme krijohen në lloj-lloj mënyrash dhe nga secili, situata komplikohet kur kësaj loje u hyjnë shtetet, me qëllim të dëmtimit të kundërshtarëve, apo arritjes së interesave të tyre. Norik Selimi, udhëheqës i kompanisë "Pikasa Analytics", që bën monitorimin e përmbajtjes së medieve në Ballkan, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se nuk është sekret se Rusia dhe shtetet e saj mike sponsorizojnë fushatë antiperëndimore në Kosovë. "Ka qendra ndërkombëtare, të cilat nuk janë mike të Kosovës, që nuk besojnë se një ditë

Kosova mund të jetë proruse, por çka mund të bëjnë është të shpërndajnë narrativë kundër Perëndimit, që të përhapet një skepticizëm ndaj partnerëve perëndimorë. Ky është qëllimi afatmesëm dhe afatshkurtër i këtyre qendrave". Duke komentuar deklaratën e ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jeffrey Hovenier, i cili ka deklaruar se aktorë të huaj duan ta minojnë demokracinë në Kosovë duke shfrytëzuar përçarjet etnike, Selimi ka thënë se ky fenomen është prezent në gjithë Ballkanin. "Kosova nuk përbën përjashtim nga Bosnje e Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut, dhe nëse ka një fushë ultrasensitive, është fusha e marrëdhënieve ndëretnike, gjithmonë. Ai që dëshiron të destabilizojë një shtet, një garniturë, gjithmonë do të tentojë përmes cenimit të marrëdhënieve ndëretnike". Ramadan Ilazi, drejtor i

hulumtimeve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), i ka thënë Radios Evropa e Lirë këtë javë se fushatat dezinformuese shpërndahen qëllimshëm në Kosovë për t'i tensionuar marrëdhëniet ndëretnike. "Kemi fushata që kanë për qëllim të krijojnë mosbesim - sidomos në mesin e komunitetit serb - ndaj institucioneve publike në Kosovë dhe që synojnë të krijojnë një lloj perceptimi sikur në veri [të Kosovës] e kemi një situatë represioni të vazhdueshëm ndaj qytetarëve atje".

## Telegram-i dhe Facebook-u

Dren Gërguri, ligjërues në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, e përmend edhe Serbinë në nivel të njëjtë me Rusinë, si

shtet keqdashës kundrejt Kosovës dhe aleatëve të saj. "Nëse flasim për komunitetin serb në Kosovë, Telegram-i është platforma ku shpërndahen shumë dezinformata për Kosovën dhe ato bëhen virale, sidomos kur ka tensione në veri, shohim që valë dezinformatash ndoshta edhe u paraprijnë tensioneve". Ai ka thënë se dezinformatat shtrihen ndryshe-ndryshe në Kosovë, sepse të ndryshme janë burimet e informacionit: Për serbët në Kosovë është aplikacioni i mesazheve Telegram - sipas tij, i mbushur me propagandë serbo-ruse - dhe disa media serbe në Kosovë dhe në Serbi, ndërsa për shqiptarët janë televizionet shqipfolëse dhe rrjeti social Facebook. "Pjesa më e rrezikshme është kur ndonjëherë po shohim media shqipfolëse, portale, të cilat shpërndajnë deklarata të zyrtarëve shtetërorë të Rusisë ose të Serbisë, dhe të cilat thjesht përcillen pa u kontestuar, në kuptimin që të tregohet kur ka manipulim, ose kur ka gjoja se fakte. Kjo është e rrezikshme, sepse informacioni vjen në gjuhën

amtare". Edhe Gërguri beson që Rusia ka një mori veglash përmes së cilave shtrin ndikimin, përfshirë mediave të mëdha si Sputnik apo Russia Today. Këtyre dy medimeve shtetërore ruse u është ndaluar transmetimi në Kosovë, në disa vende të rajonit, dhe në Bashkimin Evropian, pas nisjes së luftës së Moskës në Ukrainë. Megjithatë, në disa vende, përfshirë Kosovën, ato kanë qenë të qasshme edhe këtë vit.

## Kina si faktor shtesë

Përveç Rusisë, në një raport të zyrës së Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) në Kosovë, të publikuar këtë vit rreth qarkullimit të dezinformatave në vend, janë përmendur edhe përpjekjet e dëmshme të Kinës. Sipas gjetjeve, mediat shtetërore të të dyja vendeve kanë luajtur rol të rëndësishëm në përhapje të narrativëve keqdashës: mediat ruse kanë cituar nacionalizmin serb në Kosovë dhe kanë ngritur paralele false me Krimenë për të dëmtuar pavarësinë e Kosovës, ndërsa mediat kineze kanë kritikuar



# Kosova dhe Kroacia nënshkruajnë pesë marrëveshje bashkëpunimi

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

ZAGREB, 13 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti u mirëprit të premtën nga kryeministri i Kroacisë, Andrej Plenković. Të dy kryeministrat biseduan rreth marrëdhënieve të shkëlqyeshme bilaterale ndërmjet shteteve dhe popujve të dy vendeve. Bashkë diskutuan për marrëveshjet që u nënshkruan të premtën dhe për marrëveshjet e reja të mundshme që do ta zgjeronin bashkëpunimin në fushën e sistemit të drejtësisë, kulturës dhe arsimit.

Së fundmi, në Kroaci u nënshkrua zotimi për Themelimin e Qendrës për Studime Albanologjike "Milan Šufflay" në Universitetin e Zarës.

Qendra për Studime Albanologjike "Milan Šufflay" do të shërbejë si një platformë hulumtuese për promovimin e gjuhës, historisë, arkeologjisë

dhe kulturës shqiptare, duke i kushtuar një vend të veçantë trashëgimisë së veprës së historianit dhe albanologut të shquar Milan Šufflay.

Temë qendrore e bisedës ishin bashkëpunimi ekonomik dhe shkëmbimet tregtare, me ç'rast diskutuan për mundësitë dhe fushat me potencial për investime të huaja.

Kryeministri Kurti e njoftoi homologun e tij për ofertën e Kosovës për investitorë të huaj, krahas zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, përparimit demokratik, stabilitetit institucional dhe përmirësimit në sundimin e ligjit që ka shënuar vendi në vitet e fundit. Ai shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e vazhdueshme të Kroacisë ndaj Kosovës në rrafshin ndërkombëtar dhe në anëtarësimin dhe integrimin e saj në organizata ndërkombëtare, si dhe falënderimin për bashkëpunimin në fushën e

mbrojtjes.

Kurti, gjithashtu, e njoftoi kryeministrin kroat Plenković edhe rreth zhvillimeve të fundit në vend, me theks të sulmi terrorist i 29 nëntorit që për cak kishte popullatën civile përmes dëmtimit të infrastrukturës kritike, për çka vetëm reagimi i shpejtë dhe profesional i institucioneve përkatëse në sanimin e dëmeve ka evituar ndërprerjen apo vështirësimin e shërbimeve esenciale, si rryma, uji dhe telekomunikimi, dhe çrregullimin e jetës shoqërore, qytetare, ekonomike dhe të institucioneve.

Ai ndau me homologun e tij hollësi rreth sulmit për të cilin metoda dhe ekzekutimi i tij, së bashku me konfiskimin e armatimit, uniformave dhe emblemave të ushtrisë, shumica prej të cilave të Serbisë dhe 20 të tjera të Rusisë, tregojnë për përfshirje të aktorëve të jashtëm, teksa hetimet e institucioneve të

Republikës së Kosovës po vazhdojnë.

Në fund të takimit u nënshkruan marrëveshje për Sigurimet shoqërore dhe Protokollin zbatues; Njohjen dhe shkëmbimin e patentave të shoferëve; Bashkëpunimin në mbrojtjen kundër fatkeqësive natyrore, teknike dhe teknologjike; Memorandumin e Mirëkuptimit për bashkëpunim mes agjencive tona të forenzikës; Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Akademisë Policore të Kroacisë dhe Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për forcimin e bashkëpunimit në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor. Në deklarimin për medie pas takimit bilateral, kryeministri Kurti tha: "Për ne Kroacia është një partner kyç rajonal dhe referencë për zhvillim. Jemi mirënjohës për mbështetjen e vazhdueshme të popullit kroat, edhe para luftës, gjatë luftës e pas saj, gjithashtu edhe për

etapat rreth pavarësimit të Kosovës e konsolidimit tonë ndërkombëtar. Falënderoj Kroacinë për kontributin aktiv për sigurinë e Kosovës dhe të paqes në rajon përmes ushtarëve kroatë, që janë pjesë e misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR. Vlerat, pikëpamjet dhe historinë që ndajmë e kemi përgjegjësi që t'i përkthejmë në mirëqenie për qytetarët tanë e zhvillim të dy vendeve tona. Atë më së miri e arrijmë përmes bashkëpunimit ekonomik dhe përmes bashkëpunimit të brezave të rinj; të studentëve kroatë dhe të studentëve shqiptarë e të tjerë nga të dy vendet tona".

Në takim kryeministri Kurti ishte i shoqëruar nga ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari dhe ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, dhe ambasadori i Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj.



përfshirjen perëndimore dhe të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë, duke i portretizuar si forca destabilizuese, dhe duke vënë në pikëpyetje legjitimitetin e tyre.

## A mund të luftohen dezinformatat?

Tërësisht jo. Por, për

minimizimin e tyre, Norik Selimi ka sugjeruar:

Rregullimin e sferës së komunikimit online me legjislacionin, duke shmangur censurën, por duke ruajtur cilësinë zhdukjen e gjuhës së urrejtjes nga ana e politikës; Krijimin e transparencës për financimin e mediave. Dren Gërguri ka sugjeruar që të gjithë të kenë pikëpyetje për

atë që shohin dhe dëgjojnë dhe ta pyesin veten: Kush është autori i informacionit? A po e shoh të njëjtin informacion edhe në mediat tjera relevante? Në çfarë burimesh po mbështetet? Por, mbi të gjitha, sipas tij, është edukimi medial. "Krejt kjo me të cilën po ballafaqohemi është edhe si rezultat i mungesës së gjykimit kritik

ndaj përmbajtjeve dhe lëndës së edukimit medial, dhe këto po krijojnë një terren të përshtatshëm që dashakëqijtë ta përdorin për qëllimet e tyre".

Në Kosovë, lënda e edukimit medial është lëndë zgjedhore në disa shkolla të nivelit parauniversitar, dhe nuk ekziston një kurrikulë nacionale për të.

Përveç njohësve të fushës, synimet ruse për destabilizim të Kosovës përmes dezinformatave përmenden shpesh edhe nga figurat më të larta shtetërore.

Sipas tyre, Rusia ka për qëllim destabilizimin e Ballkanit për të çorientuar NATO-n nga lufta e Moskës në Ukrainë, ndërsa Serbia synon përmbushjen e ambicieve territoriale.



# Tre armiqtë e Albin Kurtit



Shkruan:  
Hajdin ABAZI

Atë që e kishte thënë vazhdimisht e artikuloi së fundmi me cilësim krejt të pazakontë: i tregoi cilët janë penguesit kryesor të suksesit të tij si kryeministër. Gjithçka kumbonte sikur të thoshte: këta janë armiqtë e brendshëm të partisë e të klasës (nuk do mend edhe të lidhur me armiqtë e jashtëm). Ai këtë e bëri në një event partiak, më 8 dhjetor, fill pasi partia e rinominoi (për befasinë e askujt) kandidat për kryeministër. Tërë pompozitet dhe dramacitet, ai i përcaktoi tre armiqtë e tij, të partisë e të qeverisë Kurti: **mediat**, opozitën dhe drejtësinë. Për ata që nuk e dinë, këto që ai i cilësoi si armiq janë tri shtyllat themelore të demokracisë, pa të cilat nuk ka as shtet ligjor, rend parlamentar e liri të fjalës.

Përse i targetoi pikërisht këta si armiqtë e progresit, zhvillimit dhe përforcimit të shtetit?

Kurti flet me përgjithësi për mediat, kurse, ç'është e vërteta, janë një grusht mediash e gazetarësh, ata të cilët kryeministri i ka në thumb. Dhe shkaku është një i vetëm: pse po ia zbulojnë abuzimet, kapjen e shtetit, nepotizmin, korrupsionin, aferat e skandalet e njëpasnjëshme. Në konceptin e tij, këtë e bëjnë vetëm ata që janë "armiq" ose "të shitur". Dhe theksin e vë te ata që kësajsoj e godasin atë, partinë dhe qeverinë e tij. Goditjet e tilla janë gabim, sepse mediat e gazetarët bënin mirë kur denonconin qeveritë e tjera, por jo edhe kur këtë e bëjnë ndaj regjimit të Kurtit. Këta, për të qenë në vijë, duhet ta qepin, të heshtin dhe, me gjithë qejf, hapur ose në mënyrë të kamufluar, të bëhen leva të partisë e të Kurtit dhe propagandën e tij ta paraqesin si realitet. Mendimi kritik, transparenca, denoncimet duhet t'u drejtohen opozitës, sepse ata janë e keqja (ani se qe pesë vite nuk janë në pushtet)! Me një fjalë, kryeministri u tha mediave: nëse vazhdoni t'i

zbuloni skandalet e regjimit tim, ju shndërroheni në armiq! (Dhe vetëm që nuk i rrodhi nga goja pohimi: do te ju fus në burg!).

Për **opozitën** dihet. Kur Kurti ishte në opozite kishte të drejtë të hidhte gaz lotsjellës, të bëhej xhurulldi në parlament, të gjuheshin me veze, e të etiketoheshin ata që ishin në pushtet. Kurse tash kur ai është në pushtet - opozita duhet të tregohet e moderuar, t'i duartrokasë dhe ta mbështes në gjithçka - nëse dëshiron të tregohet konstruktive. Dhe argumenti i vetëm është se ai është kryeministër. Por opozita nuk po e bën pikërisht këtë. Ajo me mjete parlamentare dhe në rrugë ligjore po e kryen misionin e vet demokratik në frenimin e ngulfatjes dhe metamorfozimit të rendit demokratik. Opozita po mendon se me dërgimin në Kushtetuese të ligjeve - të pengojë shpërfytyrimin e drejtësisë dhe të infiltrimit të nuancave autokratike që e minojnë demokracinë. Pikërisht këtë pushteti i Kurtit po e sheh si pengesë të progresit të pushtetit të tij. Dhe për aq kohë sa opozita do të veprojë kështu, është jo vetëm penguese, por edhe

armik e përtej armikut.

Po **drejtësia**? Atë kaherë Kurti e ka shpallë të kapur - nga ata që nuk janë në pushtet qe pesë vjet! Në të vërtetë, Kurti ka bërë çmos për ta kapur drejtësinë, por ende nuk ka arritur në masën që i duhet. Gjuha e tij tingëllon sikur po ju thoshte se ju jeni kolaboracionistë, me klasën e përmbysur. Bëjnë mirë kur ngrisin akuza ndaj të tjerëve, por gabojnë kur e bëjnë këtë ndaj njerëzve të Kurtit. Ata po e luftojnë Kurtin, partinë e qeverinë - vetëm pse nuk po veprojnë sipas propagandës së tij, nuk po i bëjnë urrejtje atyre ndaj të cilëve po i ndërson kryeministri. Çfarë fakte të tjera duan ata, a nuk ju mjafton që po e thotë kryeministri? Duke u përpjekur me veprua sipas procedurave ligjore dhe në përputhje me faktet (dhe pikërisht kur veprohet kështu), ata bëjnë shkelje të rëndë: nuk e përfillin vullnetin e kryeministrit - ti burgosin ata që dëshiron Kurti e ky është fakt i mjaftueshëm! Duke mos bërë kështu, ata shndërrohen në armiq të njëmendtë të kryeministrit, duke e penguar (për aq sa e pengojnë) abuzimin në emër të drejtësisë.

Pak a shumë, ky është nënteksti i asaj që Kurti i shpalli mediat, opozitën dhe drejtësinë si taborre armiqësore, që kolaborojnë mes vete për të frenuar, penguar e stagnuar marshin triumfal të Kurtit, ashtu që edhe diktatorët t'ia kishin zili. Kryeministri Kurti qeverisë në një shtet me kushtetutë që e ka në themel demokracinë, por në emër të saj i shpall armiq dhe i lufton pikërisht përbërësit relevantë të lirisë e tolerancës në rendin demokratik.

Dhe, jo vetëm kaq. Kurti po përgatitet të hidhet në kundërsulm. Me "Byronë për pasurinë e pajustificueshme", po qe se kjo hyn në fuqi, do t'i shantazhojë e intimidojë eksponentët kritik ndaj tij. Ai këtë po do ta përdorë si instrument kundër armiqve që i deklaroi, e jo për t'ua konfiskuar pasuritë e pajustificueshme kujtdo qoftë, pa dallim dhe të faktuar.

Pasi i deklaroi armiqtë të brendshëm, po e mpreh shpatën për t'u hedhë në luftë hakmarrëse të klasës. A do ta lejojë këtë drejtësia, opozita dhe mediat? A do ta tolerojnë ata që na kanë ndihmuar ta bëjmë demokracinë?

## DASH-i: Dhjetë kosovarë ishin në kampet në Siri më 2023

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Dhjetë shtetas të Kosovës vazhdojnë të jenë në kampet të personave të zhvendosur, apo në qendra të ndalimit në Siri, ndërsa për 70 shtetas të Kosovës në këtë shtet nuk ka informacione për vendndodhjen apo nëse janë gjallë. Kështu thuhet në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH), dedikuar terrorizmit në botë për vitin 2023.

Në pjesën për Kosovën përmendet se Kosova i ka riatdhesuar 121 persona dhe i ka arrestuar 12 shtetas të saj që kanë qenë në Siri. Aty është vlerësuar se, sikurse në të kaluarën, shtetasit e Kosovës vazhdojnë të jenë të cenueshëm ndaj përpjekjeve për rekrutim nga ana e organizatave të dhunshme fetare.

Pas shpërthimit të konfliktit në Siri më 2011, vlerësohet se rreth 350 kosovarë patën udhëtuar drejt Sirisë dhe Irakut, për të luftuar kryesisht krah grupit ekstremist - Shteti Islamik (IS).


Personat që janë kthyer në Kosovë janë përballur me procese gjyqësore. Megjithatë,

sipas raportit, ndonëse korniza legjislative e Kosovës parasheh ndjekjen penale të të dyshuarve për mbështetje të aktiviteteve terroriste apo pjesëmarrjen në luftërat e huaja, dënimet për kryerje të veprave terroriste janë të buta, me lirime me kusht apo lirime të parakohshme, si dhe mbikëqyrje të çorganizuar pas lirim.

Në vitin 2015 Kosova e ka miratuar një ligj të posaçëm që sanksionon pjesëmarrjen në luftëra të huaja, ndërsa Kodi Penal parasheh dënime për kryerje të veprave terroriste prej pesë vjet e deri në burgim të përjetshëm.

Zyrtarë të Shërbimit Korrektues të Kosovës i kanë thënë "Radios Evropa e Lirë" se pas proceseve gjyqësore, rreth 42 të burgosur për pjesëmarrje në luftëra të huaja kanë kaluar nëpër institucionet e tij korrektuese. Aktualisht në institucionet korrektuese ndodhen shtatë prej tyre.

Në raportin e DASH-it përmendet se prej majit të vitit 2023 Byroja Federale e Hetimeve në Shtetet e Bashkuara (FBI) ka angazhuar



një këshilltar për kundërterrorizëm që ta mbulojë rajonin e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Agjentë të FBI-së është thënë se kanë marrë pjesë në takimet e task-forcës kundërterrorizmit dhe kanë ofruar këshilla përgjatë hetimeve. Aty përmendet, po ashtu, se Qeveria e Kosovës ka punuar në mënyrë konstruktive me Shtetet e Bashkuara dhe

komunitetin ndërkombëtar në përpjekjet kundërterrorizmit më 2023, dhe që e ka miratuar strategjinë e shumëpritur dhe planin e veprimit për luftim dhe parandalim të terrorizmit, për periudhën 2023-'28, të katërtën qysh prej pavarësisë. Sa iu përket incidenteve terroriste që kanë ndodhur në Kosovë më 2023, në raport është përmendur që pas sulmit të 29 majit të atij viti të serbëve kundër pjesëtarëve të misionit

të NATO-s në Kosovë, KFOR, autoritetet e Kosovës kanë shpallur Brigadën e Veriut dhe Mbrojtjen Civile si organizata terroriste.

Është përmendur edhe sulmi në Banjskë të Zveçanit, i kryer më 24 shtator, si pasojë e të cilit është vlarë rreshteri i Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku. Kosova fajëson Serbinë për organizim dhe kryerje të sulmit, ndërsa Beogradi mohon gjithçka.



## Komandanti i KFOR-it flet për paqen dhe stabilitetin në Universitetin e Prishtinës

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Gjeneralmajori Enrico Barduani, komandant i KFOR-it në Kosovë, mbajti një ligjëratë për studentët e profesorët në Departamentin e Gazetarisë të Universitetit të Prishtinës. Në ligjëratën e tij, gjeneralmajori Barduani foli për angazhimet e KFOR-it rreth ndërtimit të paqes dhe stabilitetit në Kosovë.

Me studentët e gazetarisë u ndanë përvojat e punës edhe të Radios së KFOR-it. Radio KFOR-i u themelua nga trupat britanike në Kosovë në vitin 1999, ndërsa nga viti 2000 është bërë zëri i të gjithë ushtarëve të KFOR-it. Gjeneralmajori Enrico Barduani detyrën e komandantit të forcës paqeruajtëse ndërkombëtare



në Kosovë e mori më 11 tetor 2024.

Universiteti i Prishtinës është i përfshirë në një projekt me ushtrinë amerikane për identifikimin e rriqrave, por edhe krijesave të tjera që mund të bartin viruse, baktore dhe parazitë të rrezikshëm për ushtarët dhe popullatën në zonën e Kampit "Bondsteel".

## Osmani në ShBA, në fokus forcimi i partneritetit mes dy vendeve

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është duke zhvilluar një mori takimesh me zyrtarë të Kongresit Amerikan në Shtetet e Bashkuara, me të cilët ka thënë se po diskuton për rëndësinë e mbështetjes amerikane në shumë sektorë të vendit që udhëheq. Në "Facebook", Osmani ka thënë se është takuar me senatorët republikanë Ted Cruz, Joni Ernst dhe Thom Tillis, si dhe kongresistët Gary Palmer, Pete Sessions dhe Mike Lawler. "Bashkëpunimi dhe komunikimi i rregullt janë kyç për veprim të duhur në kohë të duhur. Kosova dhe ShBA-të, kanë hapësirë e mundësi të shumta për



hapjen e kapitujve të rinj të bashkëpunimit, andaj kjo edhe është një nga objektivat kryesor në rrugëtimin

përpara", ka thënë Osmani pas përfundimit të njërit prej takimeve. Ajo ka thënë se ka diskutuar

edhe për bashkëpunimin në fushën e sigurisë, me qëllim të parandalimit të përpjekjeve të aktorëve të dëmshëm për më shumë "kaos dhe jostabilitet". Vizita e Osmanit në ShBA është duke u realizuar disa javë para inagurimit të presidentit të zgjedhur amerikan Donald Trump. Erin Elizabeth McKee, ndihmësadministratore në Byronë për Evropë dhe Euroazi në USAID, i ka thënë javë më parë Radios Evropa e Lirë se marrëdhëniet e ShBA-së me Kosovën nuk janë lëkundur gjatë administratave të ndryshme dhe se përkushtimi i popullit amerikan ndaj popullit të

Kosovës është e bindur se do të vazhdojë. ShBA-ja ka ndarë mbi dy miliardë dollarë për Kosovën që prej vitit 1998 dhe mbështetja e saj ka qenë vendimtare, përfshirë rrugën drejt pavarësisë. Udhëheqës shtetërorë të Kosovës e përsëritin shpesh që Amerika është partnerja më e rëndësishme e Kosovës dhe se mbështetja e saj është jetike. Megjithatë, në disa raste, vitet e fundit, raportet e Uashingtonit me Qeverinë e Kosovës janë tendosur, ndonëse zyrtarë qeveritarë kanë përsëritur vazhdimisht se koordinohen dhe kanë bashkëpunim të ngushtë me ShBA-në.

## Nga 1 janari 2025 qytetarët e Bosnjë-Hercegovinës mund të udhëtojnë me letërnjoftim në Kosovë

EPOKA

ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Qeveria e Kosovës ka zhvilluar mbledhje elektronike në të cilën ka miratuar nismën për "Amendamentimin e Traktatit Bazë të Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (ICMP)". Gjithashtu, ka miratuar vendimin me të cilin nga 1 janari i vitit 2025 shtetasit e Bosnjë-Hercegovinës do mund të udhëtojnë me letërnjoftim biometrik drejt Kosovës për hyrje, tranzit dhe qëndrim afatshkurtër në territorin e Republikës së Kosovës deri në 90 ditë brenda një periudhe

gjashtëmujore, sipas Marrëveshjes për Lëvizjen e Lirë me Letërnjoftime në Ballkanin Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit. Kabineti qeveritar ka miratuar vendimin për të kërkuar nga presidentja e Kosovës për dhënie autorizimit ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga ministri i Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë". Po ashtu, është miratuar edhe



vendimi për të kërkuar nga presidentja e Kosovës për dhënie autorizimit ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, për nënshkrimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga ministri i Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Eficienca e energjisë në

ndërtesa publike". Kabineti qeveritar ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për transfer të mjeteve buxhetore në nenin 30.3 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Gjithashtu, qeveria ka aprovuar kërkesën e komunës së Zubin Potokut për aprovimin e buxhetit pas miratimit të buxhetit për vitin 2025 nga Kuvendi Komunal. Në këtë mbledhje të qeverisë është aprovuar kërkesa e Ministrisë së Mbrojtjes për rialokim të mjeteve deri nën 25 % të ndarjes së ndikuar negativisht nga kategoria e

shpenzimeve e investimeve kapitale. Po ashtu, është aprovuar edhe kërkesa e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për transferim të mjeteve buxhetore në nenin 30.3 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Qeveria ka miratuar vendimin me të cilin institucionet e Republikës së Kosovës mund të japin me qira ose në shfrytëzim pronat publike për ndërtimin e kapaciteteve të reja të energjisë nga kurimet e ripërtërishe bazuar në një proces të ofertimit konkurrues të organizuar nga Ministria e Ekonomisë.

## Minatorët e Trepçës tash e tutje do të kenë përkujdesje të shtuar mjekësore

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Minatorët e Trepçës tash e tutje do të kenë përkujdesje të shtuar mjekësore që do të mund të realizohen në kuadër të institucioneve dytësore dhe tretësore që janë në nivel të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës. Po ashtu, këtë të drejtë do ta gëzojnë edhe punëtorët e minierave të tjera që

menaxhohen nga ky institucion. Po ashtu, punëtorët do t'u nënshtrohen kontrolleve sistematike mjekësore dhe psikologjike nga ekspertët e ShSKUK-së. Ky bashkëpunim është zyrtarizuar përmes nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet ShSKUK-së dhe Sh.A.

"Trepça". Në emër të drejtorit të ShSKUK-së, Elvir Azizi, marrëveshjen e zyrtarizoi dr. Ardian Shefkju, u. d. drejtor mjekësor, kurse për Sh. A "Trepça", U. d. kryeshefi ekzekutiv Faton Ahmeti. Kjo marrëveshje është nënshkruar në afat prej 3 vjetësh, me mundësi rishikimi ndërmjet dy palëve.





# Tranzicioni energjetik për arritjen e emetimeve neto zero deri në vitin 2050 është i realizueshëm

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Banka Botërore ditë më parë ka publikuar një raport lidhur me klimën dhe zhvillimin e vendit. Në përmbledhjen e këtij raporti lidhur me zhvillimin e vendit thuhet se Republika e Kosovës, ekonomia e parafundit për nga madhësia në Ballkanin Perëndimor, ka arritur përmirësime të konsiderueshme në standardet e jetesës gjatë dekadës së fundit, por këto përfitime janë shoqëruar me disa ndikime të padëshiruara mjedisore dhe shëndetësore. "Duke pasur BPV-në më të ulët për kokë në mesin e 6 shteteve të Ballkanit Perëndimor (BP6) në vitet e fundit, Kosova është përballur me sfida të shumta në zhvillimin e saj. Tensionet politike dhe njohja e pjesshme nga komuniteti ndërkombëtar si shtet i pavarur sovran, janë bërë pengesë për investimet e huaja direkte dhe rritjen ekonomike. Kosova gjithashtu ka intensitetin më të lartë të karbonit në Evropë; me depozita të pasura të thëngjillit, vendi është mbështetur në përdorimin e qymyrit. Infrastruktura e termocentraleve me thëngjill po vjetrohët dhe po bëhet më pak efiçente. Së bashku me infrastrukturën e vjetruar të transportit, ngrohjes dhe banesave, këta faktorë po kontribuojnë më tej në

degradimin e mjedisit dhe në rezultate negative shëndetësore, duke rritur cenueshmërinë ekonomike të qytetarëve të Kosovës nga goditjet e çmimeve të energjisë dhe varfëria energjetike", thuhet në këtë raport.

Më tej, thuhet se heqja e qymyrit nga përdorimi do të kërkojë masa gjithëpërfshirëse për t'i adresuar ndikimet sociale dhe ekonomike, veçanërisht në rajonet e varura nga qymyri, për të siguruar një tranzicion të drejtë dhe gjithëpërfshirës në aspektin social. "Kapitali njerëzor i vendit gjithashtu duhet të zhvillohet në mënyrë substanciale për të siguruar që Kosova të jetë gati për tranzicionin e gjelbër; vlerësohet se më shumë se 40 për qind e potencialit të kapitalit njerëzor të vendit është aktualisht i pashfrytëzuar. Ndryshe, nga shumica e vendeve të tjera të BP6, popullata e Kosovës në moshë pune (mosha 15-64) po rritet. Planifikimi afatgjatë për përmirësimin e rezultateve të arsimit dhe aftësitë do të jetë me rëndësi jetike për t'i ofruar popullatës relativisht të re të vendit shanset më të mira për t'u bërë shumë produktive", thuhet tutje.

Po ashtu, vlerësohet se përsheptimi i tranzicionit energjetik për arritjen e emetimeve neto zero në mbarë



ekonomisë në Kosovë deri në vitin 2050 është i realizueshëm, por do të kërkojë transformim rrënjësor dhe veprim me vendosmëri në nivel kombëtar dhe rajonal. "Si pjesë e RKZHV-së për BP6 u realizua një analizë e modelimit të sistemit energjetik për të vlerësuar rrugët sektoriale të dekarbonizimit për shtetet e BP6. Objektivat dhe politikat ekzistuese klimatike të Kosovës, siç janë përshkruar në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK), janë relativisht ambicioze, por për të arritur emetimet neto zero do të jetë i nevojshëm transformimi rrënjësor i sistemit energjetik. Për ta arritur dekarbonizimin neto, termocentralet me thëngjill do të duhet të hiqen nga funksionimi dhe të nxirren plotësisht nga përdorimi deri në

vitin 2045, duke i zëvendësuar me rritje të konsiderueshme të kapacitetit të energjisë nga era dhe solare", thuhet në raportin e Bankës Botërore.

Energjia solare, e cila prodhohet me ndërprerje, do të duhet të plotësohet me rritjen e kapacitetit të baterive të akumulimit për t'i përmbushur nevojat e balancimit.

Po ashtu, vlerësohet se rritja e bashkëpunimit me vendet e BP6 dhe BE-së dhe integrimi në tregun mbarëevropian të energjisë do të jenë me rëndësi kritike për shkak të rritjes së vogël energjetik të Kosovës dhe resurseve të kufizuara. "Caku i emetimeve zero neto deri në vitin 2050 mund të arrihet me ndikim minimal në rritjen potenciale aktuale të ekonomisë. Përgjithësisht, krahasuar me

skenarin referencë (SR), për të arritur emetime zero neto në mbarë ekonominë Kosova do të duhet t'i shtojë investimet në sistemin energjetik për 760 milionë dollarë amerikanë deri në vitin 2030 dhe 4.7 miliardë dollarë amerikanë deri në vitin 2050 (të shprehur në vlera aktuale dhe në dollarë me vlerë të vitit 2020), çka është e barasvlershme me rreth 2.9 për qind të BPV-së në vit mesatarisht deri në vitin 2050. Pjesa më e madhe e këtyre investimeve do të ishte në sektorin e energjisë elektrike për ta kaluar atë nga dominimi i prodhimit të energjisë nga thëngjilli në energjinë nga era dhe solare. Do të duhet të ndodhë një ndryshim i rëndësishëm në kërkesën e investimeve private, duke kaluar nga blerja e makinave me benzinë dhe naftë në blerjen e automjeteve elektrike (AE). Ndikimi i investimeve të nevojshme për dekarbonizim në prodhimin e brendshëm do të ishte modest në krahasim me ndikimin e tyre në reduktimin e emetimeve, sepse BPV për kokë do të ishte vetëm 0.12 për qind më e ulët deri në vitin 2050, krahasuar me SR-në", thuhet, ndër të tjera, në raport. Në nivel të sektorit privat, bankat komerciale dhe kompanitë kanë shumë për të kontribuar në mbështetjen e veprimeve zbutëse dhe përshtatëse në Kosovë.

## DhTIK i shkruan kryeministrit Kurti rreth bllokadës së shkaktuar nga Ligji për Pronën Publike

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë (DhTIK) i është drejtuar me një letër kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në të cilën DhTIK ka shprehur shqetësimin e thellë për mungesën e gatishmërisë për reagimin e duhur institucional për zgjidhjen e problemeve të krijuara në funksionimin e institucioneve shtetërore të shkaktuara nga hyrja në fuqi e zbatimit të Ligjit 08/L-125 për Pronën Publike, zbatimi i të cilit ka shkaktuar bllokadë totale në funksionim të bizneseve që merren me aktivitete minerare.

Në reagim thuhet: "DhTIK ka organizuar takime të shumta me një numër institucioneve me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje për të dalë nga kjo situatë, pasi vazhdimi i bllokadës ka vënë në situatë të rëndë bizneset, të cilat përpos që po përballen me probleme ekonomike dhe shumë kompani janë në telashe nga pamundësia që t'u qëndrojnë prapa kontratave të nënshkruara, shkaku i skadimit të licencave

dhe mosvazhdimin të tyre. Kjo po sjellë probleme ligjore për ta, humbje të klientëve dhe rrezikim të humbjes së mijërave vendeve të punës".

Më tutje ka theksuar se arsyetimin e kolizionit ligjor ndërmjet Ligjit 08/L-137 për Pyjet dhe Ligjit 08/L-125 për Pronën Publike, Agjencia e Pyjeve e Kosovës (APK) më 19.06.2024 ka marrë vendim për pezullimin e shqyrtimit të të gjitha kërkesave që janë paraqitur nga bizneset lidhur me marrjen me qira të tokës pyjore. "Marrja e pëlqimit nga APK (Kontrata e qirasë së tokës pyjore) është kusht thelbësor ligjor për vazhdimin e procedurës pranë KPMM-së. Si pasojë e vendimit për pezullim të kërkesave nga APK, shumica e bizneseve minerare janë me licenca të skaduara ose në prag të skadimit të tyre, përkatësisht pranë shuarjes së tërësishtme si biznese-mbylljes së mijëra vendeve të punës", vijon reagimi. Ndër të tjera thuhet se: "Veprimtaria e bizneseve



minerare është thelbësore për funksionimin e tërë industrisë së ndërtimit në përgjithësi dhe të veprimtarive të tjera ekonomike përcjellëse. Në rast të ndërprerjes së punës në aktivitetet minerare, pushon e tërë industria e ndërtimit dhe industritë tjera përcjellëse, si dhe humben mijëra vende aktive të punës".

Në reagim thuhet se, përveç humbjes së mijëra vendeve të punës, shteti humbet miliona euro nga tatimet e drejtpërdrejta që merren nga bizneset minerare dhe të ndërtimtarisë, si dhe

tatimet e tjera që derivojnë nga këta sektorë crucialë të ekonomisë vendore. "Sektori minerar, të cilit i takojnë bizneset tona, është kontribuuesi i tretë më i madh në mbushjen e Buxhetit të Kosovës pas Doganës së Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK)", vazhdon reagimi. Gjithashtu, thuhet se mosgatishmëria për gjetjen e një zgjidhjeje është evidentuar edhe në takimin e organizuar nga Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime të mbajtur më 11 dhjetor.

Kryetari i DhTIK-së, Skender Krasniqi, ka thënë se sektori i gurthyesve, ai i betonit dhe i asfaltit janë në situatë të rëndë. "Kemi dhjetëra biznese që kanë ndërprerë punën. Kemi qindra biznese që kanë humbje edhe në biznes edhe në punëtorë. Në kuadër të Dhomes kemi grupin punues, ku janë mbi 100 biznese të sektorit minerar. Si rezultat i këtij ligji, MBPZHR-ja nuk mund të lëshoj leje. KPMM nuk vazhdon licencën. Kemi pas takime me Zyrën e Kryeministrit edhe me shefen e GP të LV-së. Është premtuar se do të bëhet shpejtë një zgjidhje, por fatkeqësisht nuk ka pasur asnjë lëvizje. Si rezultat i kësaj, ne kemi rënie të prodhimit vendor dhe në anën tjetër kemi rritje të importit nga Serbia dhe Maqedonia e Veriut. Ne kërkojmë më urgjencë që kjo situatë të zgjidhet për shkak se kanë mbetur biznese në situatë të vështirë, pasi nëse nuk gjendet një zgjidhje, ne do të jemi të detyruar të ndërmarrim masa tjera", ka deklaruar Krasniqi.



# LISTAT E DUBRAVËS, DYZIT E SMREKONICËS!



Behxhet  
Sh. SHALA - BAJGORA

**Kriminelja në vend të kimit:** Prokurorja e GJRS e Hagës, Kimberly West, e njohur si kriminele juridike që e kurdisi aktakuzën e dytë kundër presidentit Thaçi sikur që dhunoi përmes bastisjeve dhe arrestimeve shumë familje patriotike dhe intelektuale shqiptare në Kosovë, brenda një kohe të shkurtër ishte dy herë në Kosovë; para bastisjeve dhe arrestimeve të shoqëruar me një aktakuzë të Danica Marinkoviçit dhe tash, mbase për të kërkuar "prova" për arrestime tjera dhe riciklim të dhunës së shfrenuar kundër UÇK-së, shqiptarëve, veteranëve të luftës, kundërshtarëve të kësaj monstre juridike, mediave të panështruara, analistëve që me vonesë u ka hyrë zhetoni për këtë kriminale dhe ndonjë donkishoti të vetmuar. Nuk u bë publik lajmi me kënd u takua e që është në përputhje të plotë me natyrën kriminale të punës së kësaj prokurorie; të gjitha punët i kryen në terr, me njerëz faqezinj, pa transparencë dhe pa i dhënë llogari askujt përveç Aleksandar Vuçiqit, Vulinit, Hekuran Teneqes, Besnik Gjylekares, Lenka Qukos, Haxhi Qamilit, Dhunues Cveklës dhe Katran Kanalizimkës. Kriminelja juridike, te kriminelët institucionalë dhe kriminelët antikombëtarë!

**Më në fund listat:** Lista e fundit e dorëzuar në KQZ ishte ajo e LV-së, diku para orës 24:00 kur ishte afati i fundit. Realisht, afati i fundit ishte ora 16:00 por se u zgjatë deri në ora 24:00 shkaku i LV-së, derisa i arroi listat. Përpilimi i listave është lufta më e madhe brenda partive politike dhe këtu thyhen shtizat, thuhet fjalë të rënda, ka kërcënime, shantazh, korrupsion aktiv dhe pasiv,

rrezikohen miqësitë, kërcënohen partitë me sabotim e njëqindmijë faqe të zeza. Mirëpo, në fund arrihet një "paqe romake" pas së cilës listat dorëzohen te fatosi i Albin Kurtit, Kreshnik Radoniqi. Po, çka në fakt përbëjnë këto lista dhe a sjellin ndonjë mundësi për ndryshim?! Para se të flasë për 10-shet e partive kryesore me duhet të prekë prurjet e reja, jo se do të sjellin ndonjë ndryshim por se duhet të respektojmë vullnetin e tyre, ashtu si janë e jo t'i linçojmë, pa mundësi mbrojtjeje. E kaluara e tyre duhet të marrë përgjigjen e votuesit e jo pushkatimi publik. Në rininë time të hershme mbaj mend se deputetë në Parlamentin e Italisë ishte zgjedhur Illona Staller - Cicolina (emër artistik, si Besnik Gjylekari), e që askush nuk merrej me të, ishte atraksion i vërtetë i Parlamentit për faktin se ishte yll i njohur (porno star), i industrisë pornografike. Pastaj, edhe në parlamentin italian dhe atë evropian zgjidheshin deputetë me vepra të rënda penale për të fituar imunitet nga ndjekja penale. E pse ne duhet të bëjmë përjashtim kur edhe ashtu kemi shumë prostituta politike në Kuvend dhe gjithpërfshirje të atyre me aktakuza dhe vepra të ndryshme penale.

**Prurjet:** LV-ja nuk arriti ta bëjë ndonjë transfer kualitativ intelektual, profesional dhe politik. Gazmir Racin dhe Nezir Krakin nuk i konsideroj prurje, ata ishin trumpeta të LV-së, njëri nga Parisi, tjetri nga Prishtina. Së paku tash nuk mund të quhen analistë, të pavarur jo se jo, as deri dje nuk ishin të tillë. Këta nuk i sjellin vota LV-së por se në debate mund të përdoren si vuvuzela, asgjë më shumë. Bylbyl Sokoli "Profa", të shprehem me gjuhë të futbollit, ende pa filluar garën politike e mori kartonin e kuq nga Drenica që automatikisht e përjashton nga loja. Edhe ashtu është zënë në offside - pozitë jashtë loje, e që do të thotë se e ka të pamundur të fitojë minuta në lojën politike që është 100 herë më

e ndyrë se ajo e futbollit. Edona Llallosi i ka hyrë politikës në minutat e fundit pa e kuptuar se në skenën politike nuk këndohet kënga e saj por ajo e Albinit. A mund ta këndoje ajo këngën e Albinit, nuk e besoj mësa e këndoi Sabriano këngën e Hashimit. Nuk pajtohem që sulmohet për rripin Valentino, nuk e ka blerë me para të LV-së por me punën e saj. As me vlerësimin për axhën e saj, Qazimin, ne lllapjanët e njohim më mirë. Askush nuk mban përgjegjësi për fajet e të tjerëve, nëse i kanë bërë, pse ta bëjë këtë Edona. Unë në vitin 1981 jam arrestuar politikisht në Sarajevë me urdhër politik të Xhevdet Hamzës. Asnjëherë për këtë nuk më ka shkuar mendja të hakmerrem në Fatos Hamzën apo Agon Hamzën. Gruan time Fexhrije Shalën brutalisht e kanë rrahur, mes të tjerëve, Gazmend Maliqi dhe Sahit Ismajli. Në kohën kur fëmijët e mi janë të papunë, fëmijët e udhësëve Maliqi kanë poste dhe paga të majme. I njoh por nuk jam hakmarrë. Të afërmit e kriminelit Sahit Ismajli kanë qenë drejtues të KEK-ut kurse bija e tij, në regjimin e Kurtit 2 është bërë drejtoreshë e një klinike në QKUK.

**1. LV:** 10-eshi i kësaj partie, bashkë me kondomët Guxo dhe Alternativa, në një shtet ligjor, me një SPAK kosovar, 40 për qind do të përfundonin në BSL në DyZ, 30 për qind në Dubravë dhe 30 për qind në Smrekonicë. Në rrethana që jemi garojnë dhe shpresojnë për një fitore të madhe. Në këtë listë hiç 2 kandidatëve mund të gjëni çdo gjë me përjashtim të kombëtares që nuk e gjëni as në gjurmë. Kjo, në fakt është ajo Kutia e Albin Pandores nga, pa e pyetur fare pronarin po dalin djaj që dje shiteshin si engjëj. Albini është peng i tyre dhe jeta politike e tij varet nga heshtja - omerta e banuesve të Kutisë së Pandores. Kjo listë nuk ka të bëjë fare me LV-në burimore, është pikërisht e kundërta. A e ka merituar këtë Albini dhe ata që janë vrrarë apo vetëvrrarë për Albinin dhe LV-në?! Për flamurin kombëtar

dhe bashkimin kombëtar. Flamuri kombëtar në LV tash po përdoret si gjethe fiku për ta mbuluar lakuriqësinë e mashtrimit kurse , bashkimi kombëtar tani është përgjegjësi e Nenad Rashiqit, Erden Atiqit dhe Alim Ramës. Kush do ta besonte këtë?! As Baba Vanga, jam i sigurt.

**2. PDK:** Më pengon qasja folklorike e përshkrimit të prurjeve si, djali i Shkurtës, djali i Jakupit, baba i Granitit etj. Ata, në fakt në lista zgjedhore garojnë me emër dhe mbiemër që e kanë e jo me këto epitete folklorike dhe emocionale. PDK-ja e ka një listë shumë të mirë e përbërë nga kuadro burimore e që kombinohet me 60 për qind që garojnë për herë të parë. Personalisht mendoj se Përparim Gruda, Arben Mustafa dhe zonja Ramaj është dashur të renditen në 10-shin e parë. Kuadrot e dëshmuara të PDK-së nuk ka aspak rëndësi cilin numër rendor e kanë, i fitojnë votat pa asnjë problem. E mira e kësaj liste është se nuk e kanë asnjë kandidat me aktakuzë apo të dënuar. Lista ofron kandidatë shumë të mirë për debate mediale me partitë tjera.

**3. LDK:** Ka një listë respektabile në aspektin profesional, politik dhe intelektual. 10-shi i parë është i përbërë nga skeleti i dinozaurit të LDK-së. Risi e vetme është Doarsa Kica që renditet e treta në listë, sipas meje krejtësisht e ka merituar. Bashkë me Hykmeten, Vlorën, Jehonën, Sibelin dhe Lirijen përbënë ekip me potencial të madh përfaqësues.

**4. AAK - NISMA:** 10-shi i parë është i imponuar shkaku i koalicionit. Besnik Tahiri, me një përvojë të madhe politike ka kapacitet ta përfaqësojë politikisht shumë mirë koalicionin kurse Bekë Berisha është mbrojtje e fortë e luftës çlirimtare dhe grusht i fortë i kundërshtarëve të kësaj lufte plus ka fituar një përvojë politike. Forumi i intelektualëve aspak nuk e rritë votën e këtij koalicioni n. Koalicionin e mbanë karizma e Ramushit dhe e Dautit për të cilët mendoj se duhet të dalin

në debate sa më pak. Besnik Tahiri, Ardian Gjini dhe Arton Demhasaj duhet ta bartin barrën kryesore në debate vendimtare.

**5. Lista për Familjen:** Në 10 - in e parë ka Emanin, Feridin dhe Selim Pacollin që përbëjnë trojkën goditëse për sigurimin e votave për kalimin e pragut zgjedhor që besoj se e kalojnë. Situata aktuale iu shkon për favor kurse më së shumti vota do t'i fitojnë nga "Lëvizja e Deçanit" sepse dihet mirë se njëri ekstrem e forcon ekstremin tjetër.

Në zgjedhjet e ardhshme do të ketë shpërndarje të votave, asnjë parti apo koalicion nuk e kalon 30 përqindëshin, mbase as i fiton 30 për qind. Pjesë e Kuvendit të ardhshëm do të jenë, LV, PDK, LDK, AAK - NISMA dhe besoj edhe Lista për Familjen. Më e rëndësishme do të jetë se kush do të bëjë koalicion se kush do t'i fitojë zgjedhjet. Fituesi nuk do të vendosë për koalicion por jo fitues-it.

**Sherife Osmani, kaubojsa e Zhabarit:** Presidentja e Kosovës, Vojsa Osmani, me Llaskucin e Parë nuk po i ndahen bishtit të aeroplanit e sidomos Amerikës. Ose kanë vendosur të jetojnë atje e të hapin ndonjë biznes, ose po mendon që karrierën politike ta vazhdojë atje. Ende pa i hequr rrobat nga udhëtimi i fundit, hop e në Amerikë, gjoja për t'u takuar me kongresmenë republikanë në kohën kur pushtetin ende e ka Sleeping Joe dhe demokratët. Ju kujtohet që në Katedralen Notre Dame i theu këmbët duke përndjekur Trumpin, Muskun, zonjën Macron dhe të tjerët për një shtrëngim duarsh dhe foto për album familjar ndërsa në komunikatat nga presidenca fitohej përshtypja se gjatë atyre takimeve është vendosur për fatin e botës. Mashtrues të paskrupulltë! Kam përshtypjen se në këtë vizitën e fundit, Vojsa Osmani ka shkuar për të siguruar një biletë hyrëse për ceremoninë e inaugurimit të presidentit Trump që, përveçse ia begaton albumin familjar, në të njëjtën kohë ia mbush xhirollogarinë... në varg.





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Kosova dhe Shqipëria mësojnë kundërshtaret për kualifikimet e Kupës së Botës 2026

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Kosova dhe Shqipëria kanë mësuar kundërshtaret për kualifikimet e Kupës së Botës 2026, pasi shorti është tërhequr në Cyrih të Zvicrës. Kosova është tërhequr në Grupin B, ku janë katër ekipe. Krahas "dardanëve" në këtë grup janë edhe Zvicra e Granit Xhakës dhe shqiptarëve të tjerë, Suedia dhe Sllovakia. Kosova me Suedinë u përballë edhe në kualifikimet e kaluara të Botërorit 2022, me Zvicrën në kualifikimet për "Euro 2024" si dhe me Slloveninë në kuadër të Ligës së Kombeve në vitin 2020. Shortin e ka komentuar përzgjedhësi Franco Foda, i cili e vlerëson grupin, por thotë se asgjë nuk është e pamundur. "Është një grup i vështirë, por shumë i balancuar. Avantazhi është se nuk duhet të udhëtojmë larg dhe tani do të merremi shumë intensivisht dhe në mënyrë specifike me kundërshtarët. Në këtë grup gjithçka është e mundur", ka thënë Foda. Goglat e kualifikueseve të Botërorit vendosen në të njëjtin grup Shqipërinë dhe



Serbinë. Kuqezinjtë do të përballen me serbët pas plot 10 vitesh. Në gjithë historinë, Shqipëria dhe Serbia janë përballur vetëm dy herë. Dueli i famshëm i 14 tetorit 2014 të zhvilluar në Beograd u la përgjysmë pas sjelljeve vandale të vendasve, teksa Shqipëria fitoi në tavolinë 0-3, ndërkohë në sfidën e 8 tetorit të vitit 2015 serbët fitonin në "Elbasan Arena" me rezultatin 0-2. Shortin e ka komentuar edhe trajneri brazilian i Shqipërisë, Sylvinho, i cili bëri me dije se e priste një grup të tillë të vështirë. "E prisja. Janë skuadra të forta. Grup i fortë. Ishim në vazon e tretë dhe e prisim që e para dhe e dyta do të ishin skuadra të forta. Është një kompeticion shumë i shpejtë. Për ne çdo garë do të jetë finale. Ne kemi një ëndërr për

të shkuar përpara. Është një garë si të tjerat, por kjo ka një histori pas, por ne jemi këtu për të luajtur futboll dhe për të bërë gjëra të bukura. Megjithatë, historia është shumë e rëndësishme. Është një ndeshje shumë e rëndësishme, por ne jemi këtu për të luajtur futboll", ka thënë Sylvinho. Faza e grupeve kualifikuese do të fillojë në mars 2025 dhe do të përfundojë në nëntor 2025. Formati i këtyre kualifikimeve është me 12 grupe me katër ose pesë ekipe, e ku fituesit e grupeve do të sigurojnë një vend në Kupën e Botës. Katër vendet e mbetura do të vendosen më pas në mars 2026 në një "play-off" të UEFA-s me 16 ekipe që përfshijnë 12 skuadrat e pozitave të dyta të fazës së grupeve dhe katër fituesit më të mirë të grupeve

### GRUPET E BOTËROKIT 2026:

Grupi A: Fituesi Gjermani/Itali, Sllovakia, Irlanda e Veriut, Luksemburgu  
 Grupi B: Zvicra, Suedia, Sllovenia, Kosova  
 Grupi C: Humbësi Portugali/Danimarkë, Greqia, Skocia, Bjellorusia  
 Grupi D: Fituesi Francë/Kroaci, Ukraina, Islanda, Azerbajxhani  
 Grupi E: Fituesi Spanjë/Holandë, Turqia, Gjeorgjia, Bullgaria  
 Grupi F: Fituesi Portugali/Danimarkë, Hungaria, Republika e Irlandës, Armenia  
 Grupi G: Humbësi Spanjë/Holandë, Polonia, Finlanda, Lituania  
 Grupi H: Austria, Rumania, Bosnja Hercegovina, Qipro, San Marino  
 Grupi I: Humbësi Gjermani/Itali, Norvegjia, Izraeli, Estonia, Moldavia  
 Grupi J: Belgjika, Uells, Maqedonia e Veriut, Kazakistan, Lihtenshtajni  
 Grupi K: Anglia, Serbia, Shqipëria, Letonia, Andorra  
 Grupi L: Humbësi Francë/Kroaci, Çekia, Mali i Zi, Ishujt Faroe, Gjibraltari

të Ligës së Kombeve 2024-2025, të cilët as nuk janë kualifikuar drejtpërdrejt në Kupën e Botës si fitues të grupeve dhe as nuk hyjnë në "play-off" si nënkampionë në grup. Kupa e Botës do të fillojë më 11 qershor në Mexico City, ndërsa do të përfundojë më 19 korrik në New Jersey.

### Trajneri i Zvicrës: Synojmë fitore ndaj Kosovës

Trajneri i Zvicrës, Murat Yakin: "Është grup i fortë, një sfidë e madhe për ne. Do të luftojmë dhe do të mundohemi ta luajmë lojën tonë në mënyrë që ne ta kemi rolin e favoritit. Kemi ekip të fortë dhe po shikojmë para për këto ndeshje. Ka ende shumë për të kompensuar. Ne

u eliminuam nga Kupa e Botës 2018 në Rusi kundër Suedisë dhe nuk kemi fituar në tri ndeshje kundër Kosovës".

### Trajneri i Serbisë vlerëson Shqipërinë: Rival serioz, fokusi ynë vetëm futbollit

Trajneri i Serbisë, Dragan Stojković: "Shqiptarët kanë treguar përmirësim në lojën e tyre së fundmi dhe sigurisht që do të jenë një kundërshtar i vështirë. Jam i lumtur që do të luajmë në Tiranë në stadiumin ku u luajt edhe finalja e Ligës së Konferencës. Jam i vetëdijshëm se dy duelet do të jenë interesante për disa arsye të tjera. Për sa na përket neve, nuk vihet në dyshim asgjë që nuk ka lidhje me futbollin. Kemi mundësi ta tregojmë veten".

## Sërish përballja Peja - Prishtina

PEJË, 13 DHJETOR - Peja - Sigal Prishtina përballen sërish, por këtë herë në javën e 12-të të Pro Credit Superligës. Ky është derbi i tretë për një kohë të shkurtër, ku dy skuadrat me traditë u përballën dy herë për Kupë. Në çerekfinale të Kupës shënuan nga një fitore ndaj njëra-tjetrës, por bardhekaltrit kishin koshdallim më të mirë nga dy sfidat dhe kaluan në gjysmëfinale, ku do të ndeshen

me rivalen tjetër, Trepçën. Në elitën e basketbollit pejanët kanë pesë fitore dhe gjashtë humbje, ndërsa prishtinasit gjashtë fitore e katër humbje. Trepça - Proton Cable Prizreni, po ashtu, u përballën në çerekfinale të Kupës, ku mitrovicasit fituan dy ndeshjet dhe kaluan në gjysmëfinale. Takimi do të zhvillohet sërish në Prizren. Kampionët e Kosovës janë në vendin e parë



me nëntë fitore dhe dy humbje, kurse prizrenasit kanë tri fitore e tetë humbje. Të dielën do të zhvillohet sfida shumë e

rëndësishme ndërmjet Vëllaznimit dhe Borës. Kuqezinjtë kanë katër fitore

### PROCREDIT SUPERLIGA - JAVA 12

Të shtunën takohen:  
 17:00 Peja - Sigal Prishtina  
 19:00 Trepça - Proton Cable Prizreni

Të dielën takohen:  
 17:00 Vëllaznimi - Bora  
 19:00 Bashkimi - Golden Eagle Ylli

dhe shtatë humbje, derisa prishtinasit dy fitore e tetë humbje, andaj pritet një sfidë mjaft interesante në Gjakovë. Java e 12 do të përmbyllet me takimin, po ashtu mjaft interesant, ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Bashkimit. Therandasit kanë gjashtë fitore e pesë humbje, ndërsa prizrenasit tetë fitore e tri humbje, prandaj do të jetë një luftë deri në fund për fitore.

## Dukagjini mposht Ferizajn

KLINË, 13 DHJETOR - Dukagjini ka shënuar fitore me rezultat minimal 1-0 në shtëpi ndaj Ferizajt në kuadër të javës së 17 në Albi Mall Superligën e Kosovës. Që nga minutat e para të kësaj sfide, të besuarit e

Ismet Munishit ishin më kërkues dhe eventualisht e gjetën golin që në fund doli të ishte i fitores. Rasti i parë për gol ishte në minutën e 35-të kur Altin Mërlaku mori përsipër ekzekutimin e gjuajtjes së lirë, por ajo u

ndal nga muri. Kërcënimi më serioz për portën e Ferizajt erdhi në minutën e 36, por goditjen e Hekuran Berishës e priti me shumë mund Jovanovski. Goli i fitores për klinasit erdhi në minutat e fundit të

ndeshjes, më saktësisht në minutën e 83-të përmes Altin Mërlakut, i cili realizoi për rezultat përfundimtar 1-0. Kjo ishte fitorja e parë për Dukagjinin në elitë pas tri humbjeve radhazi dhe tashmë numëron 20 pikë në



pozitën e gjashtë në tabelë, teksa Ferizajt renditet në pozitën e nëntë me 17 sosh.



## City, rekord të të ardhurave vjetore

**MANCHESTER, 13 DHJETOR** - Manchester City ka njoftuar për një rekord të ri të të ardhurave në Premierë Ligë prej 715 milionë paundësh në llogari deri më 30 qershor 2024. Të ardhurat e klubit u rritën me 2.2 milionë paund nga 712.8 milionë, që kishte

qenë më e larta deri tani. Kjo ndodhi në një vit ku nuk arriti ta përsërisë triumfin historik të trefishtë të vitit 2023, por duke siguruar titullin e katërt radhazi në Angli, si dhe fitoret në Kupën e Botës për Klube dhe Superkupën Evropiane.

Klubi ka siguruar fitim çdo sezon që nga 2014-15, përveç sezonit 2019-20 të prekur nga Covid-19. Manchester City është në pozitë të mirë për ta përforcuar skuadrën e Pep Guardiols në afatin e ardhshëm të transferimeve,

pas një serie prej 10 ndeshjesh me vetëm një fitore. Kryetari Khaldoonal - Mubarak theksoi se organizata ka në ADN-në e saj ambicien për përmirësim të vazhdueshëm. Manchester City vazhdon të jetë një nga klubet më të



fuqishme ekonomikisht në futbollin botëror pavarësisht prej sfidave sportive dhe ligjore.

## Wladimir Klitschko pranë rikthimit në ring pas tetë vjetësh

**LONDËR, 13 DHJETOR** - Ukrainasi Wladimir Klitschko po mendon një rikthim shokues në ring, me shpresën që të ketë mundësi të duelojë për të fituar një tjetër titull kampion bote në peshën e rëndë, në moshën 48-vjeçare. Klitschko nuk ka boksuar që nga humbja e tij në vitin 2017 ndaj Anthony Joshuas. Spekulumet janë shtuar nga fakti se ukrainasi, dominues në peshat e rënda në kohën e tij, po tundohet nga ideja për të qenë sërish kampion bote në një moshë të madhe. Tom Loeffler, i cili themeloi K2 Promotions me vëllezërit Klitschko, zbuloi për "SkySports" detaje nga ky rikthim. "Unë e di se në një moment ishte një ëndërr e tij ta thyente rekordin e George Foremanit dhe të bëhej kampioni më i vjetër i peshave të rënda. Nuk dua të flas për Vladimirin. Do ta lë vetë atë që të thotë gjithçka që lidhet me këtë çështje", ka thënë Loeffler, që la të hapur mundësinë e rikthimit të legjendës ukrainase



asaj që ndodh, ne mund ta shohim atë si një mundësi e mirë për të dalë nga pensioni dhe të rikthehet në ring. Shumë varet nga ajo që do të ndodhë më 21 dhjetor", ka shtuar Loeffler. "Nuk ka ambasador më të mirë për boks se Wladimiri dhe vëllai i tij Vitali. Nëse e rikthejmë Vladimirin përsëri në ring mendoj se shumë fansa do të ishin shumë të emocionuar ta

të ringut.

Janë katër tituj të mëdhenj botërorë për të cilët Klitschko mund të duelojë në rikthim. Tyson Fury dhe Oleksandr Usyk do të përballen për tri prej tyre (WBC, WBO dhe WBA), në revanshin e 21 dhjetorit. Daniel Dubois mban rripin e katërt dhe të fundit (IBF) dhe do ta mbrojë atë në shkurt ndaj Joseph Parkerit. "Wladimiri nuk dëshiron të duelojë ndaj Usykut sepse ai është bashkatdhetari i tij. Por tani, me boksierë të tjerë në ring si Daniel Dubois dhe në varësi të

shihnin përsëri", ka shtuar Loeffler. Klitschko humbi titujt në duelin ndaj Tyson Furyt në vitin 2015, ndërsa revanshi mes tyre nuk u zhvillua asnjëherë. "Nëse ka një shans që Wladimiri të kthehet në ring, do të jetë vendimi i tij, por ne do ta mbështesim. Këtë gjë bëri edhe Mike Tyson. Është në formë të jashtëzakonshme. Ai stërvitet gjatë gjithë kohës, qëndron në formë, është një nga njerëzit më atletikë që kam takuar ndonjëherë. Por, le të shohim", ka përfunduar Loeffler.

## Bostoni triumfon dhe synon kreun në Lindje, fitojnë edhe Miami e Sacramento

**BOSTON, 13 DHJETOR** - Bostoni fitoi me rezultat 123-99 ndaj Detroitit dhe iu afrua kreut të renditjes në Konferencën e Lindjes. Ndeshje e dominuar nga skuadra e Celticsit, ku u dallua Payton Pritchard, autor i 27 pikëve dhe 10 asistimeve. Mirë u paraqit edhe White me 23 pikë. Fitoi edhe ekipi i Miamit, 114-104 ndaj Torontos, sfidë ku skuadra nga Florida dominoi në fushë. Tyler Herro me 23 pikë e Bam Adebayo me



21 pikë bënë dallimin në fushë për skuadrën e Miami Heat. Në sekondat e fundit fitoi Sacramento, që mundi me

rezultat 111-109 në fushë New Orleans. Ndeshje magjike për Sabonis, që realizoi 32 pikë e 20 rebounde, mbështetur edhe nga De Rozani me 29 pikë, ndërsa 36 pikët e McCollumit për vendasit mbetën për statistikë.

### REZULTATET

Boston - Detroit	123-99
Miami - Toronto	114-104
New Orleans - Sacramento	109-111

## Tyson: Nuk e mbaj mend luftën kundër Jake Paul, as nuk e di pse e bëra

Një muaj pas luftës kundër Jake Paul, Mike Tyson dha një intervistë për "FoxSports Radio" në të cilën zbuloi se nuk mban mend asgjë nga meçi i asaj dite. 58-vjeçari amerikan humbi me vendim të gjyqtarëve pas tetë rundesh

ndaj 27-vjeçarit Paul dhe me meritë, duke pasur parasysh se ai arriti të godasë YouTuberin vetëm 18 herë në të gjithë luftën. Legjendari "Iron Mike" ka marrë 78 grushte dhe ka treguar se as që i mban mend. "Nuk e mbaj mend luftën. Më

ra të fikët pak. Më kujtohet vetëm fillimi i raundit të dytë, Jake po bënte diçka, nuk e kuptoja se çfarë", ka thënë fillimisht Tyson, i cili padyshim kujton vetëm se Pauli iu përkul në fillim të raundit të dytë. Siç thotë ai,

nuk i mban mend ato 78 goditje që ka marrë, por që kanë lënë gjurmë tek ai. "Nuk e mbaj mend forcën e grushteve të tij, por më dhembte i gjithë trupi pas përleshjes, veçanërisht gjoksi dhe stomaku". Kur u pyet nëse i

vjen keq që rihyri në ring në fund të viteve pesëdhjetë, Tysoni ishte i sinqertë. "Një ditë pas përleshjes u zgjova dhe e pyeta gruan time: 'Pse u ndesha?' Thjesht nuk e di se çfarë drejtin po ndodhte", ka përfunduar boksieri legjendar.

### SHKURT

#### Trajneri i Evertonit para ndeshjes me Arsenalin: Është në planin tim

Numri një i stolit të Evertonit, Dyc Sean, ka folur së fundmi për Armando Brojën dhe mundësitë reale që ka sulmuesi kuqezi që të aktivizohet në ndeshjen e radhës ndaj Arsenalit. "Broja do të jetë në çdo strategji që do të ndërtojmë për këtë duel delikat. Ai kurrë nuk ka qenë larg mendimeve të mia për sa kohë ka qenë i shëndetshëm. E aktivizova për pak minuta përballë Wolves për t'i dhënë mundësi që t'i shijonte pak emocionet e ndeshjes. Ai ka një rrugë të gjatë përpara se të rikthehet në maksimumin e tij fizik. Ai po tregon se kërkon të rikthehet kompetitiv në grup dhe më pas të jetë i tillë edhe në fushë", ka thënë Sean.

#### Reali e dëshiron Kimmichin si pasardhës të Kroosit

Drejtuesit e Real Madridit kanë nisur menjëherë punën për gjetjen e zëvendësuesit të 34-vjeçarit Toni Kroos, i cili u pensionua pas "Euro 2024". Deri më tani dy janë emrat që pëlqehen për ta mbushur boshllëkun që do të krijojë Kroos, me presidentin e "Galaktikëve", që kërkon në Madrid me njërin prej Joshua Kimmich i Bayern Munich apo Rodri të Manchester City. Sigurisht që blerja e ndonjërit prej tyre nuk do të jetë mision i lehtë, por çdokush e ka të vështirë të refuzojë kur 14 herë fituesit e Ligës së Kampionëve të trokasin në derë, diçka që e pranon edhe Kimmich, i cili ka kontratë me "bavarezët" deri në verën e vitit 2025.

#### Evra: Ronaldo e donte kalimin te PSG-ja

Cristiano Ronaldo u largua nga Real Madridi në vitin 2018, pas nëntë vitesh të suksesshme, duke firmosur me Juventusin, ku qëndroi deri në vitin 2021. Megjithatë, destinacioni i yllit portugez mund të kishte qenë një tjetër, siç zbuloi Patrice Evra për "RMC Sport". Pjesëmarrës në programin 'Rothens' enflamme', ish-lojtari ndërkombëtar francez tregoi: "A ka dashur ndonjëherë Ronaldo të shkojë te PSG? Po, para se të firmoste për Juventusin. Ai kishte disa mundësi: Chelsea, Juventus, PSG-ja, Arsenali... ai tha se kurrë nuk do të shkonte tek Arsenali dhe ishte i interesuar për projektin e PSG-së". Evra e ndau dhomën e zhveshjes me Ronaldon midis viteve 2006 dhe 2009 te Manchester Unitedi. Ish-mbrojtësi mendon se lojtari portugez do të ishte përshtatur mirë në Francë: "Mund ta kritikoni Cristianon, por ai do të ishte përshtatur. Do të kishte bërë përpjekje. Shihni çfarë po bën në Arabinë Saudite. Është sikur të jetë saudit!". Sulmuesi përfundimisht firmosi për "Zonjën e Vjetër", që pagoi 117 milionë euro për transferimin e tij, ku fitoi Serinë A dy herë para se në vitin 2021 të rikthehej te Manchester Unitedi.









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales







# TRADITË QË NGA

# 1992

